

**Njoftim për përqendrim me të cilin KON-TEK KONTROL TEKNOLOZHILERI VE OTOMASJON SANAJI TIXHARET ANONIM SHIREKTI, R.TURQISË do të fitojë kontrollin mbi Shoqërinë për prodhim tregti dhe shërbime ASI TRADE-M SHPK Shkup, Maqedonia e Veriut (lënda nr. 08-57 / 2025)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 06.03.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin KON-TEK KONTROL TEKNOLOZHILERI VE OTOMASJON SANAJI TIXHARET ANONIM SHIREKTI me seli në rrugën 7405 numër 8 Pinarbaşi Bornova Izmir R.TURQISË do të fitojë 85% të pjesëmarrjes në Shoqërinë për prodhim tregti dhe shërbime ASI TRADE-M SHPK Shkup me seli në rrugën Sllavko Janevski nr. 3-2/86 Kati-5 Shkup - Qendër, përmes shitblerjes së pjesës.

**-KON-TEK KONTROL TEKNOLOZHILERI VE OTOMASJON SANAJI TIXHARET ANONIM SHIREKTI** - Fusha e veprimtarisë - shërbime për instalimin e pajisjeve për kontrollin e proceseve industriale (përfshirë automatizimin e mbështetur). Shoqëria në shtetin e saj amë vepron në disa segmente të sektorit të energjisë me qëllim të sigurimit të efikasitetit energjetik, kryen ndërtimin sipas parimit "çelës në dorë" të sistemeve elektrike dhe sistemeve të automatizimit në impiantet elektrike, zhvillon projekte për ndërtimin e centraleve diellore nga burimet e rinovueshme sipas parimit "Çelës në dorë". Në tregun ndërkombëtar, Shoqëria ka marrë pjesë në projekte të ndryshme si në Gjeorgji, Bullgari, Qipro Veriore, Libi, Spanjë dhe Egjipt, në vazhdim do të përmbledhim disa nga projektet e përfunduara:

Shoqëria ka realizuar projekt për ndërtimin dhe elektrifikimin e plotë të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza nga furnizimi me energji deri te automatizimi, d.m.th. në impiantin për trajtimin e ujërave të zeza përdoret energji intensive në varësi të procesit dhe pajisjeve që përdoren gjatë funksionimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, ndërsa kostot e energjisë janë pjesa më e rëndësishme e buxhetit të kryerësve të kësaj veprimtarie. Menaxhimi i energjisë në ujërat e zeza dhe impiantet e pastrimit, për shkak të rritjes së kostove të energjisë, është bërë problemi më i rëndësishëm në nivel global. Duke përdorur metoda inovative është vendosur një sistem ku në impiantin e pastrimit është arritur efikasitet energjetik me ulje të konsiderueshme të kostove të energjisë.

KON-TEK KONTROL TEKNOLOZHILERI VE OTOMASJON SANAJI TIXHARET ANONIM SHIREKTI ka realizuar projekt për elektrifikim të plotë nga hartimi i projektit, furnizimi i transformatorëve dhe qelive, prodhimi dhe projektimi i paneleve të automatizimit, furnizimi me energji sipas parimit çelës në dorë.

KON-TEK KONTROL TEKNOLOZHILERI VE OTOMASJON SANAJI TIXHARET ANONIM SHIREKTI ka marrë pjesë në projekt për ndërtimin dhe kryerjen e punimeve hidraulike: automatizimi dhe sistemi i operimit të 6 stacioneve të pompimit me tension të mesëm;

Në Libi, KON-TEK KONTROL TEKNOLOZHILERI VE OTOMASJON SANAJI TIXHARET ANONIM SHIREKTI ka marrë pjesë në projektin shtetëror hidraulik "Great Man-Made River" ndërtimi i sistemit të tubacioneve që sjellin ujë të pastër nga burimet në qendrat e qyteteve, automatizimi i pompave dhe stacioneve të ujit për furnizim.

Veprimtaria kryesore e KON-TEK KONTROL TEKNOLOZHILERI VE OTOMASJON SANAJI TIXHARET ANONIM SHIREKTI është të ofrojë zgjidhje inxhinierie për investitorët duke kombinuar zgjidhje për prodhimin e energjisë elektrike, ndërkohë që gjatë vetë prodhimit arrihet efikasitet energjetik duke përdorur burime të rinovueshme të energjisë dhe në çdo fushë të industrisë me teknologji për automatizim digjital dhe vizualizim deri në fazën përfundimtare të dorëzimit të projektit sipas parimit "Çelës në dorë".

KON-TEK KONTROL TEKNOLOZHILERI VE OTOMASJON SANAJI TIXHARET ANONIM SHIREKTI në sektorin e energjisë aktualisht luan një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis me projekte të qëndrueshme dhe me vlerë të shtuar në të gjithë Turqinë, me 7 njësitë e saj kryesore operative që përbëhen nga: Energy Storage, Automation, Drives, Engineering, Solar, Solar Alliance dhe Solargy.

KON-TEK KONTROL TEKNOLOZHILERI VE OTOMASJON SANAJI TIXHARET ANONIM SHIREKTI nuk ka pjesëmarrje në asnjë kompani tjetër në Maqedoninë e Veriut.

**-Shoqëria për prodhim tregti dhe shërbime ASI TRADE-M SHPK Shkup** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari themelore prodhimin e energjisë elektrike. Shoqëria zhvillon projekt solar/fotovoltaik në f. Toolovo, Komuna e Probishtipit me fuqi nominale prej 111MWP. Ky projekt është në fazën e zhvillimit, përkatësisht ndërtimit të centralit solar dhe në periudhën më të afërt të mundshme pritet të fillojë me prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike.

Shoqëria për prodhim tregti dhe shërbime ASI TRADE-M SHPK Shkup nuk ka pjesëmarrje në asnjë kompani tjetër në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet t'i arrijnë Komisionit brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

14.03.2025

Shkup